



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:273802

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05269303

C. nr. 1069/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Astrit Gashi dhe sekretaren juridike Fatmire Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditësit **M.H nga Komuna Glllogoc** të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj sipas autorizimit Xh.B, avokate në Glllogoc, kundër të paditurës **Komuna e Glllogocit, Drejtoria për Arsim**, me objekt kontesti **kompensim i shujtës ditore dhe të udhëtimit**, me vlerë të kontestit prej **808.20 €**, jashtë seancës me datën 31.01.2024 e mori këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

- I. APROVOHET** i si e bazuar kërkesëpadia e paditëses **M.H nga Komuna Glllogocit**, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Glllogocit, Drejtoria për Arsim që paditëses të ia kompensoj shumën e tërësishme prej **808.20 €** dhe atë: në emër të **shpenzimeve të udhëtimit** shumën prej **368.20 €** (tre qind e gjashtëdhjetë e tetë euro e njëzet cent) për ditët e pranisë në punë prej gjithsejt 526 ditë pune **për periudhën kohore prej datës 01.09.2019** gjer me datën 21.11.2022, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 24.08.2023 kur është paraqitur padia me datën 06.12.2021 e deri në pagesën përfundimtare, dhe në emër të **shujtave ditore** shumën prej **440 € (katërqind e dyzet euro)** për ditët e pranisë në punë prej gjithsejt 220 ditë pune **për periudhën kohore prej datës 01.09.2021** gjer me datën 21.11.2022, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 24.08.2023 kur është paraqitur padia e zgjeruar e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.
- II. DETYROHET** i padituri që paditësit të ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 124 € (njëqind e njëzet e katër euro), në afat prej shtatë (7) ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.
- III. REFUZOHET** si e pabazuar kërkesa e paditësit që i padituri të detyrohet t'ia paguaj edhe shpenzimet procedurale mbi shumën e aprovuar nga pika II të këtij dispozitivi.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së tij, me datë 06.12.2021 kundër të paditurës për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit për 526 ditë të punës për periudhën prej datës 01.09.2019 gjer me datën 21.11.2022, duke theksuar se paditësja është e punësuar tek e paditura me kontratë pune

si mësimdhënës në SHMP “Fehmi Lladrovci” në Glllogoc. Padiësi ka kërkuar që në bazë të nenit 35 par. 5 dhe 7 Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, ti njihet e drejta në kompensimin e udhëtimit në periudhën e lartëcekur dhe atë në shumën e përgjithshme prej **368.2 €** Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Me datën 24.08.2023, përfaqësuesi me autorizim i padiësës ka paraqitur pranë kësaj gjykate parashtrësë për precizim dhe zgjerim të padisë dhe kërkesëpadiësë, ndërsa e ka precizuar dhe plotësuar dhe rregulluar kërkesëpadinë për këtë kompenzim të udhëtimit për të përfshirë periudhën tjetër kohore prej datë 01.09.2019 gjer me datën 21.11.2022 për gjithsej 526 ditë të pranisë në punë në shumën prej 368.2€, dhe e ka zgjeruar padinë me kërkesëpadinë e re për kompenzim të ushqimit për periudhën kohore prej datës 01.09.2021 gjer me datën 21.11.2022 për gjithsej 220 ditë pune në shumën prej 440 €, të gjitha këto në shumën prej 808.2€ **me kamatë ligjore prej 8% në vit nga dita e paraqitjes së padisë e gjer në pagesën definitive.**

E paditura, me anë të përgjigjes në padi të datës 15.11.2023 në padinë e datës 06.12.2021 dhe të plotësuar, precizuar dhe zgjeruar me datën 24.08.2023, **nuk ka kontestuar se padiësi është në marrëdhënie pune** tek e paditura por e ka kontestuar kërkesëpadinë e saj duke theksuar se kërkesëpadija bazohet në kontratën kolektive të vitit 2017 e cila nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e të drejtës së kërkuar me padi dhe se të njëjtit nuk i takon kompenzimi i shujtës sepse **nuk është anëtar i sindikatës (SBASHK)**. Tutje ka theksuar se kërkesëpadija e padiësit është **e pas afatshme** sepse kontrata kolektive e arsimit e vitit 2017 është lidhur për një afat prej 3 vitesh sipas nenit 90 të Ligjit të Punës, ndërsa lidhur me **kërkesëpadinë për vitin 2021 ka theksuar se punëdhënësi ka afat për sigurimin e këtyre kërkesave deri në vitin 2023**, dhe në fund ka theksuar se *ushqimi dhe udhëtimi nuk është borxh kryesor ose dëm ndaj padiësit ashtu që i njëjti nuk ka të drejtë as në kamatë*. Poashtu, ka njoftuar gjykatën se për padiësin është shqyrtuar një procedurë përmbarimore për kompenzim udhëtimi bazuar në vendimin e inspektoratit të punës ndaj të cilit nuk kanë ushtruar prapësim.

Gjykata ka pasur parasysh përgjigjen në padi të paditurës në të cilën e ka **kontestuar kërkesëpadinë e padiësit, e njëjta nuk i ka mohuar faktet vendimtare** sepse për të **nuk ka qenë** kontestuese se padiësja është mësimdhënëse tek e paditura, përveç që e ka kontestuar afatshmërinë e padisë bazuar në kontratën kolektive të vitit 2017, **nuk e ka kontestuar se të njëjtës i takon e drejta e kompenzimit të shujtës ditore dhe kompenzimi i shpenzimeve të udhëtimit në bazë të kontratave kolektive sektoriale** me vet faktin se ka theksuar se *“kontrata ka qenë e vlefshme vetëm deri me datë 18.04.2020, çka do të thotë se kompenzimi për ushqim për ditët e pranisë në punë pas datës 18.04.2020, nuk mund të pranohet sepse nuk ka bazë ligjore”* dhe *“lidhur me kërkesëpadinë për vitin 2021 ka theksuar se punëdhënësi ka afat për sigurimin e këtyre kërkesave deri në vitin 2023”*.

Sa i përket afatshmërisë së padisë është vërtetuar se padia është e afatshme sepse e njëjta është paraqitur me datë 06.12.2021, periudhë kjo gjatë të cilës ka qenë në fuqi kontrata kolektive sektoriale e arsimit e datës 22.01.2021 e cila përfshin edhe periudhën para 19.07.2020 dhe pas, dhe është plotësuar, precizuar dhe zgjeruar padia dhe kërkesëpadija nga përfaqësuesi me autorizim i padiësës me datën 24.08.2023 për të përfshirë edhe periudhën kohore të kërkesëpadiësë për periudhën 2020-2023 për kompenzim të shpenzimeve të udhëtimit dhe ka zgjeruar padinë me kërkesëpadi të re për kompenzim të shujtës ditore për periudhën 2021-2023 gjer me datën 21.11.2022, edhe kjo brenda afatit ligjor prej 3 viteve sepse është paraqitur brenda afatit me datën 22.08.2023.

Në lidhje me pretendimin e të paditurit se padiësja nuk është anëtare e SBASHK-ut andaj nuk ka të drejtë në shujtë, gjykata vlerëson se nuk është i bazuar sepse nuk është kusht i domosdoshëm për të realizuar të drejtat nga marrëdhënia e punës në sektorin e arsimit. Sa i

përket pretendimit se kontrata kolektive nuk ishte në fuqi nga data 18.04.2020 kjo nuk është i bazuar për shkak se Neni 45 i Kontratës Kolektive të vitit 2017 përcakton se: *nga kontrata kolektive palët mund të tërhiqen tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese e cila tërheqje fillon së zbatuar. Në ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse kontrata kolektive pasi të i skadojë afati i përcaktuar nuk tërhiqet asnjëra palë zbatimi i saj vazhdon edhe një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjashtëmuajorin e parë aplikohen rregullat e kontratës së vjetër*”. Kjo nënkupton se për periudhën prej 18.04.2020 gjer në lidhjen e kontratës së re kolektive me datën 22.01.2021 aplikohet kontrata e vjetër dhe atë edhe 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës së re gjer me datën 22.07.2021, dhe në vazhdim gjer në 22 nëntor 2022 aplikohet kontrata e re kolektive. Në lidhje me pretendimin tjetër se *ushqimi dhe udhëtimi nuk është borxh kryesor ose dëm ndaj paditësit ashtu që i njëjti nuk ka të drejtë as në kamatë, kjo nuk është e bazuar për shkak se kompensimi për ushqim dhe udhëtim janë të drejta nga marrëdhënia e punës dhe rrjedhimisht kërkesë kryesore.*

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga Neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”* lidhur me Nenet 143 dhe 147 të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Andaj, gjykata, konform Neni 152 të LPK-së gjeti së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të Neni 35, paragrafi 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë nr. 2056 të datës 18.04.2017 dhe asaj nr. 105 të datës 22.01.2021 në fuqi gjer me datën 22.11.2022 (me dispozita të njëjta në të dy kontratat) – ku përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditës e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Po ashtu me nenin 35 para. 5 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë, parashihet se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse i paguhen shpenzimet e rrugës të 70% të trafikut urban”*.

Gjykata me rastin e vendosjes për paditësen lidhur me kompensimin e shujtës ditore është bazuar në Vërtetimet e SHMP “Fehmi Lladrovci” në Glllogoc nr... të datës 22.08.2023 ku paditësi ka pasur për vitin shkollor 2019-2020 gjithsejt 127 ditë pune dhe për vitin shkollor 2020-2021 ka pasur 179 ditë pune në total 306 ditë aktive në punë, ndërsa sipas Vërtetimit të të njëjtës shkollë nr... të datës 29.08.2023 paditësi prej datës 01.09.2021 gjer me datën 30.06.2022 ka pasur 184 ditë pune, ndërsa me Vërtetimin e të njëjtës shkollë nr... të datës 25.09.2023 prej datës 01.09.2022 gjer me datën 21.11.2022 paditësi ka pasur 36 ditë pune, apo në total prej datës 01.09.2021 gjer me datën 21.11.2022 paditësi ka pasur 220 ditë aktive në punë të cilat kur shumëzohen me 2 € për një shujtë ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit del që shuma për kompensimin e shujtës ditore të jetë 440 € për periudhën prej datës 01.09.2021 gjer me datën 21.11.2022.

Ndërsa në bazë të atyre vërtetimeve, paditësi në periudhën prej datës 01.09.2019 gjer me datën 21.11.2022 ka pasur gjithsejt 526 ditë aktive në punë (306 ditë dhe 220 ditë), e kjo ndërlidhur me Vërtetimin të N.T “K...”, të datës 02.12.2021 dhe të kuponit fiskal të datës 02.12.2021, lartësia e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit të paditëses për një relacion kushton 0.50 €, ndërsa për dy relacione vajtje-ardhje brenda ditës kushton 1.00 €, sipas kësaj kur pjesëtojmë vlerën 1.00 € me 100% fitojmë vlerën 1.00 € këtë vlerë e shumëzojmë me 70% dhe fitoj vlerën 0.70 € dhe duke marrë parasysh se paditësi ka 526 ditë pune prej datës 01.09.2019 gjer me datën 21.11.2022, të cilat kur shumëzohen me vlerën 0.70 €, atëherë shuma që e paditura duhet ti kompensoj paditësit për udhëtim është 368.20 €.

Kamata ligjore është vendosur në kuptim të dispozitave të Nenit 382 të LMD-së.

Vendimin nga pika I e dispozitivit që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform Nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet, përpilimit të padisë në shumën prej 104 €, dhe për taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 €, apo shumën e tërësishme të tyre prej 124 €. Kurse vendimin nga pika II e dispozitivit me të cilën është refuzuar kërkesa e paditësit për shpenzime procedurale lidhur me: *hartimin e parashtrësës me plotësim të provave shumën prej 104 € dhe për seancës gjyqësore shumën prej 135 €*, gjykata e ka mbështetur në Nenin 453 par. 1 lidhur me Nenin 463 par. 1 të LPK-së, e njëjta nuk është mjaftueshëm e arsyetuar, dhe nuk janë shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, dhe nuk është e mbajtur ndonjë seancë gjyqësore sepse është vendosur me aktgjykim pa shqyrtim të çështjes.

Duke u bazuar në të dhënat e lartëcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C. nr. 1069/2021, me datë 31.01.2024

Gjyqtari
Astrit Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të tij pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.